



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 339/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesat e koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendotimit nr.1906E/17R, dhe vendotimit nr. 1713C/03R, e publikuar në web faqen e KQZ-së, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** si të palejuara ankesat A.nr 339/2017 dhe Anr.340/2017 tw datës 13.06.2017, e parashtruar nga koalicioni LDK-AKR, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër qendrës se vendotimit 1713C/03R, në fshatin Baran komuna e Pejës dhe qendrës se vendotimit 1906E/17R, në Fakultetin Filologjik në Prishtinë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat me datë 13.06.2017, nga koalicioni LDK-AKR, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se në vendotimin 1906E/17R, ne Fakultetin Filologjik në Prishtinë koalicioni LDK-AKR, ka 0 vota që është e pamundur. Andaj kërkojmë që të behët përmirësimi i te dhënave të futura në sistem ose te bëhet hapja e kutisë dhe të numërohet edhe njëherë votat dhe si dëshmi ka bashkangjitur 3 fotografi te printuara. ndërsa ne vendotimin 1713C/03R në fshatin Baran komuna e Pejës, koalicioni ka 95 vota ndërsa janë publikuar ne ueb të KQZ-së, vetëm 5 vota pra kemi të bëje me gabime teknike gjatë futjes se të dhënave në sistemi gabimisht. Ankesa si dëshmi është bashkangjitur 3 fotografi të printuara.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me nr.Anr

147/2017 për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të tri ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesat janë të palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

**A nr. 339/2017 më datën 14.06.2017**



**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykata Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.